

AKT-THEMELIMI

(KONTRATË)

THEMELIMIN E SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"LEMARRC" SH.P.K

Bazuar në Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar nëpërmjet Ligjit 129/2014 datë 02.10.2014, dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë fushën e regjistrimit, licensimit dhe funksionimit të subjekteve tregtare në Republikën e Shqipërisë, në Tiranë, sot, më datë 09.01.2024, z. Seweryn Dawid~~s~~ Slaski lindur në Milanowek, më 24.10.1976 dhe banues në Rubbertweg 1, 44319 Dortmund und, Gjermani, shtetas Polak, mbajtës i ID: EL3037251, me nr. Personal 76102402310, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar me vullnetin e lirë, vendos të krijoj Shoqërinë Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar "LEMARRC" sh.p.k.

Neni 1

Formohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "LEMARRC" sh.p.k me themelues:

- Z. Seweryn Dawids Slaski lindur në Milanowek, më 24.10.1976 dhe banues në Rubbertweg 1, 44319 Dortmund und, Gjermani, shtetas Polak, mbajtës i ID: EL3037251, me nr. Personal 76102402310

Neni 2

Shoqëria tregtare "LEMARRC" sh.p.k do të ketë selinë në adresën:

Rruga "Hoxha Tahsim", Pallati Vjetro, Shkalla 103, Ap.1, 1012 Tiranë

Veprimtaria e saj do të jetë me kohë të pacaktuar.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj ekonomike në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe në cdo shtet tjetër të huaj, me miratim të Asamblesë së Përgjithshme dhe në përputhje me ligjet e vendit apo shtetit përkatës ku do ta ushtrojë këtë veprimtari, duke zbatuar dispozitat dhe ligjet e vendit ku ushtron veprimtarinë.

Neni 3

Shoqëria është person juridik: shqiptar. Veprimtaria e saj zhvillohet sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar, kësaj kontrate dhe statutit të shoqërisë të cilat janë të pandashme. Shoqëria është me përgjegjësi të kufizuar dhe përgjigjet vetëm për pasurinë e vet dhe në asnje rast nuk përgjigjet për detyrimet e ortakut/ortakeve jashtë kushteve të kësaj kontrate. Gjithashtu dhe ortakut/ortaket nuk përgjigjen personalisht për detyrimet e shoqërisë dhe nuk ngarkohen në asnje rast për detyrimet jashtë kuotës së tyre në krijimin e shoqërisë përveç rasteve kur ai/ata vullnetarisht marrin përsipër për një gjë të tillë.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 4

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë tregtare "LEMARRC" sh.p.k është:

- Aktivitet tregtar në fushën e minerare, prodhim dhe shitje. Shfrytëzim karriere, prodhim blloqe guri e mermeri, inerte me fraksione të ndryshme, pllakor, dekorativ guri natyral dhe të përpunuara në mënyra të ndryshme.
- Aktivitet tregtar në fushën e ndërtimit si investitor dhe ndërtues.
- Ndërmjetësim tregtar për shitjen e pasurive të paluajtshme. Agjenci imobiliare.
- Ngritje, ndërtim, lartësim ose ndërrim i cdo lloj ndërtese, vepre ose makineri të nevojshme që e ndihmojnë dhe shërbejnë nevojave të shoqërisë.
- Sipërmarrje, projektim dhe zbatim i objekteve civile dhe industriale.
- Import, eksport, tregti të artikujve të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit.
- Aktivitet tregtar në fushën e projektimit të projekteve të ndryshme.
- Prodhim parafabrikatesh, elementesh të gatshëm, skela, bazamente të realizuara si elemente bazë ose ndihmës.
- Zhvillim, kreditim, finacim e sigurim i projekteve dhe veorave ndërtimore me karakter civil dhe industrial.
- Aktivitet tregtar në fushën e hoteleri, turizëm, bar, restorant, hotel.
- Lëshim i garancive, letrave dëmshtëpërlimi dhe cdo garanci tjetër reale brenda kufujve të përcaktuara nga ligji.
- Aktivitet tregtar në fushën e këshillimit finaciar, teknik ndërtimi, ekonomik, juridik.
- Pjesëmarrje në tendera brenda dhe jashtë vendit.

Neni 5

Kapitali themelor i shoqërisë është caktuar në shumën 100.000 lekë dhe për bëhet nga 1 kuotë me vlerë nominale prej 100.000 lekë. Kapitali themelor i takon themeluesit në masën 100% të tij. Themeluesi do të derdhë në llogaritë e shoqërisë shumën e caktuar brenda 90



ditëve nga data e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar.

Neni 6

Shoqëria fillon veprimtarinë e saj prodhuese apo tregtare pas regjistrimit të saj si person juridik dhe në regjistrin tregtar. Fitimi i realizuar nga veprimtaria e shoqërisë do të përdoret nga ortakët. Ortakët disponojnë lirisht fitimin e tyre.

Neni 7

Organet drejtuese të shoqërisë janë: **Asambleja e Përgjithshme & Administratori**

Themeluesi i shoqërisë është:

- Z. Seweryn Dawids Slaski lindur në Milanowek, i biri i Wlodzimierz, më 24.10.1976 dhe banues në Rubbertweg 1, 44319 Dortmund und, Gjermani, shtetas Polak, mbajtës i ID: EL3037251, me nr. Personal 76102402310

Administrator i shoqërisë është Z. Sajmir Beqiri, i biri i Arshiut, i datëlindjes 17.05.1985, lindur në Shupenzë dhe banues në Tiranë, në adresën Rruga "Teli Ndini", Tiranë. Mënyra e formimit dhe funksionimi i këtyre organeve përcaktohen me statutin e shoqërisë.

Neni 8

Ortakët detyrohen të ruajnë karakterin e fshehtësisë të gjithë dokumentacionit, informatave, etj. Duhet të merren masat e plota për të shmangur përhapjen e cdo të dhëne që ka të beje me shoqërinë dhe që vlerësohet si sekret tregtar në bazë të dispozitave ligjore në fuqi në vendin e ushtrimit të aktivitetit.

Neni 9

Shoqëria mund të kryejë cdo veprim juridik që ka të beje me objektin e veprimtarisë së saj.

Neni 10

Kjo kontratë lidhet për një periudhë kohe të pacaktuar. Ky afat mund të ndryshojë me vendim të organit kompetent në përputhje me statutin e shoqërisë dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 11



Dispozita të hollësishme për shoqërinë dhe funksionimin e saj përcaktohen në statutin e shoqërisë që i bashkangjitet dhe është pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve nëse nuk gjejnë zgjidhje me bisedime e mirëkuptim, do të zgjidhen në Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë.

Neni 12

Kjo kontratë u përpilua në kater kopje të njëjta në gjuhën shqipe duke depozituar kopjen në QKB për kryerjen e procedurave të rregjistrimit në Rregjistrin Tregtar dhe në cdo organ që kërkohet sipas ligjeve në fuqi.

Tiranë, më 09.01.2024

ORTAKËT THEMELUES

SEWERYN DAWIDS SLASKI

Seweryn Dawid Slaski

DS